REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA JURIDIKE,PROKURORIMEVE DHE ASETEVE

Nr.3626Prot. **Lushnje më,16/04/2026**

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

" PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSIA E QEVESISJES VENDORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENSINË SHTETËRORE TË KADASTRËS LUSHNJE"

Të nderuar këshilltare/këshilltarë!

Pranë Institucionit të Bashkise Lushnjë është paraqitur kërkesa e Z. Aleksander Naun Gjermeni për të përfunduar proçedurën e rregjistrimit të truallit të dhënë për ndërtim nga njësia vendore e cila ka mbetur pa u regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjensisë Shtetrore të Kadastrës " ASHK "Lushnjë.

Aplikuesi Z. Aleksander Gjermeni.me adresë Lagjia "Kongresi i Lushnjës", Bashkia Lushnjë ka paraqitur dokumentacion të plotë referuar vendimit nr.329,datë 22.05.2019 pika 2, pika 11. Leje Ndërtimi nr.7 datë 24.11.2004. Vendim i KRRT nr.7 ,datë 24.11.2004 për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij me sipërfaqe ndërtimi 217 m2. Vërtetim nga dokumenti hipotekor me nr. 286 datë 07.06 .2005. Plan rilevimi datë 05.01.2026 të hartuar nga topograf i lishensuar. Shkresës vulosur elektronikisht të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetrore të Kadastrës Lushnjë ku pasuria me nr.21/225 , në zona kadastrale 8571 është tokë shtet. Kontratë noteriale Nr.rep 1091,Nr.kol 35 datë 28.05.2005. Dokumenti që këtij aplikuesi i mungon që të kryej rregjistrimin e tokës truall është kontrata e shitblerjes së tokës përpara noterit dhe kryerjes së pagesës së truallit në shumen 1.289.384 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e katër) lek .

E drejta që i mungon që të kryejë rregjistrimin e tokës truall është kontrata e shitblerjes së tokës para noterit.

Këtë atribut aktualisht për miratimin e procedurës së privatizimit të tokës truall e ka Këshilli Bashkiak ku në zbatim të nenit 8 pika 2,neni 9 pika 1.2 gërma"a" *Njësitë e vetëqeverisjes vendore*

ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; gërma "c" *Ky atribut ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër pika 1.6 gërma"a", neni 54 të* ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*i ndryshuar. Vendimit nr.329,datë 22.05.2019 pika 2 *"Objekt i këtij vendimi janë tokat e dhëna për për qellime ndërtimi nga bashkitë, ish komunat dhe ish këshillat e rretheve (në vijim të quajtura "organe vendore"pas datës 10.08.1991*,pika 9.1,e kanë Këshillat Bashkiak, të cilat bëjnë të mundur lidhjen e kontratës së shitblerjes me Institucionin e Bashkisë Lushnje.

Faleminderit për mirëkuptimin !

DREJTORIA JURIDIKE
BEDRI HIDA

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

Nr3626/1 Prot.

Lushnjë, më 16/04/2026

PROJEKT- VENDIM

NR. 39 DATË 16/04/2026

" PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSIA E QEVERISJES VENDORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENSINË SHTETËRORE TË KADASTRËS LUSHNJE"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ___/___/2026 sipas relacionit të paraqitur në mbështetje të *nenit 8 pika 2,neni 9 pika 1.2gërma"a"dhe"c",pika 1.6 gërma "a", të* ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar. Vendimit nr.329,datë 22.05.2019 pika 2,pika 4,pika 6,gërma"a"pika 9.1,VKM nr.89 datë 13.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Neni 192 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,paragrafi II rregjistrimi i P.P të bëhet në bazë të një akti publik,të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj" si edhe nenit 193/b të Kodit Civil **JU** :

PROPOZOJMË :

I. Të miratohet përfundimi i proçedurave të rregjistrimit të trojeve të dhëna për ndërtim nga njësia vendore,*sipas dokumentacionit përkatës të ndodhur në dosje për* z.Aleksander Naun Gjermeni.Të paguhet vlera e truallit në shumen 1.289.384 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e katër) lek .

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lushnjë ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit para noterit.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPERISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com